

LETËRSIA EVROPIANE DHE LETËRSIA SHQIPE – ANALIZË KRAHASIMTARE

Gjylë TOTAJ

Universiteti i Prizrenit „Ukshin Hoti“, Fakulteti i Filologjisë, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

gjyla_totaj@hotmail.com

UDC 82.091

Conference paper

Përmbledhje

Sa i përket letërsisë krahasimtare janë një varg interpretimesh dhe mendimesh nga studiues të ndryshëm, të cilët kanë qasje dhe opinione të ndryshme. Të gjithë e vlerësojnë se të krahasuarit është element kyç i vlerësimit të veprave letrare, por edhe në cilëndo disiplinë shkencore. Në tërësinë e opusit të tij filozofi amerikan Charles Sandres Peirce thotë se, për një vepër a për një ngjarje nuk mund të themi asgjë të argumentuar në qoftë se atë vepër nuk mund ta krahasojmë me diç.¹

Por, brenda punimit, provojmë edhe të ofrojmë shembuj të krahasimeve të veprave të letërsisë konkretisht të dy teksteve poetike, njëra e Xh. Rumi dhe tjetra e N. Frashërit, të cilat reflektojnë relacionet komunikuese ndërmjet tyre. Madje, te të dy krijuesit subjekti lirik ngritet mbi një personifikim i cili fund e krye i përshkon të dy poezitë edhe pse Naimin dhe Rumin i ndan jo vetëm koha, por edhe hapësira. Pra, e gjithë situata e dhënë te njëri apo tjetri autor të bën të kuptosh shumë lidhur me idetë e tyre krijuese, por edhe të lënë hapur idenë se mund të thuhet akoma më shumë. Po kështu, të befason fakti se problemi artistik shfaq dashuri e ideologji që të lënë hapur mendimin e idesë rrëfyese të tyre.

Key words: *Letërsia, kënga, simboli, metafora, dashuria, fyelli.*

Në vend të hyrjes

*“Poeti nuk mund të krijojë pa e ndier më parë frymëzimin,
pa dalë jashtë vetes dhe pa e humbur kontrollin e arsyes”.*

Platoni

¹ Beker, Miroslav: *Hyrje në letërsinë komparative*, Kroaci, 1995, fq. 1.

Poezia është art deifikues. Platoni thoshte: “Nuk ka madhështi pa ndikimin e hyjnive, pa frymëzim nga qielli. Nëse këto mungojnë, arti shembet, bëhet diçka si mesatar”. Në një gjendje të këtillë gjendej edhe shkrimtari i madh persian Xhelaledin Rumi (1207-1272) i cili ndikoi mbi shumë shkrimtarë e veçanërisht mbi Naim Frashërin e për ta konkretizuar këtë ndikim do t’i krahasojmë vjershat: “Kënga e fyellit” shkruar nga Rumi i njohur me vjershën “Fylli” të Naim Frashërit.

“Dëgjoje ti zërin e fyellit pse vallë po qan e vajton,
Për dertet e ndarjeve tona, lëndimet e kohës që shkon”²

Dhe:

“Pa dëgjo fyellin ç’thotë
Tregon mërgimet e shkreta,
Qahet nga e zeza botë,
Me fjalë të vërteta”³

Te përbashkat e këtyre poezive (autorëve)

E përbashkëta është se të dytë na drejtohen me nga një imperacion, me nga një simbol e me nga një personifikim, e që të gjitha janë figura të fuqishme stilistike për të na tërhequr vëmendjen se ç’do të na thonë shkrimtarët për këtë instrument magjik të cilin e kemi vështirë ta kuptojmë. Te Rumi kemi urdhërin e përgjithshëm: ta dëgjojmë zërin e fyellit, ndërsa Naimi na drejtohet që ta dëgjojmë fjalën e fyellit, pra e përbashkëta, për të dytë, krahas imperacionit është nyja e personifikimit, këtu tejet e fuqishme.

Lajtmotivet janë gjithashtu të përbashkëta: fyelli qan dhe vajton, te Rumi, ndërsa te Naimi ai, pra fyelli me zërin e tij, “tregon mërgimet e shkreta” dhe vajton i detyruar nga “e zeza botë” prandaj edhe duhet t’i besojmë, e që prej këtyre lajtmotiveve del tema e subjektit lirik, këtu fyellit të personifikuar, temë kjo mistike e përhapur në letërsinë e Lindjes prej nga pësonte ndikime Naimi ynë. Madje te të dy krijuesit subjekti lirik ngritët mbi një personifikim i cili fund e krye i përshkon të dy poezitë edhe pse Naimin dhe Rumin i ndan jo vetëm koha, por edhe hapësira.

² Teksti i dhënë nga profesor Osman Gashi.

³ Naim Frashëri, Fyelli, teksti i dhënë nga profesor Osman Gashi.

Sipas profesor Zejnullah Rrahmanit, “Në librin e Parë të ‘Masnavisë’ Rumi ka shtjelluar idenë qendrore të këtij libri dhe idenë qendrore të gjithë ‘Masnavisë’ metaforën e jetës njerëzore në botën e gjerave materiale ku është hedhur ajo. Duke qenë një qenie shpirtërore e mbyllur në trupin material, qëllimi jetësor i individit do të jetë rikthimi në gjirin e Krijuesit. Simbol i kësaj jete për Rumin është fyelli i kallamit. Për ta bërë një fyell, njeriu e prenë kallamin dhe ia vë në boshllëkun e tij një ‘gjuhëz’ dhe e detyron atë të ‘këndoje’ melodinë e tij të përvajshme, në të cilën, e bukura dhe dhembja e pikëllimi shpërndahen në trajta të barabarta.

Ky fyell prej kallami është njeriu. Te e fundit, për Rumin kallami është një simbol universal i njeriut, përveç kësaj për të ka edhe një rëndësi figurative: kallami – fyell dhe kallami – penë me të cilën do të shkruhet vepra e tij e famshme spirituale e poetike. Kjo vepër kështu del si një vepër e kënduar dhe e shkruar. Shpirti e ka mbushur atë boshllëk material të njeriut të hedhur në botën materiale dhe larg nga Krijuesi. Në poezinë dhe në personalitetin e Rumi këto dy funksione pothuajse janë të barabarta.

Muzicienti dhe poezia e poetit

Midis Rumi muzicent dhe Rumi poet ekziston lidhja e fuqishme dhe e thellë që ia mundëson të gjejë shprehjen e vetë të unitetit shpirtëror: “Unë jam fyell, muzika është e Jotja’ – do të këndoje ai, kurse në hapin tjetër që shënon nivelin në vijim, ai do të të: ‘jo – jo. Aty është arti i fyellit dhe muzikës, duke sugjeruar kështu që të gjitha janë brenda unitetit të Krijuesit. Mbrenda Unitetit Hyjnor nuk ka kurrfarë separacioni dhe se muzikari, fyelli, muzika, fryma që i jep jetë, të gjitha në thelb janë në atë unitet. Vetëm se, Shpirti i njeriut si individ, vendoset nga Qenia Supreme në trupin material dhe hidhet në botë”.⁴

Tërë atë boshllëk të përmendur e të kënduar te Rumi e deklaroi fyelli si instrument i personifikuar që di të lëshojë psherëtima të dhembshme të përcjellura me lotët e dëshpërimit, kurse te Naimi do të kemi ngashërime:

“Kur hyri bariu kallamishtes dhe preu në mes drurin tim,
Psherëtimat dhe lotët u derdhën dhe brenda u fsheh dëshprim”.

⁴ Zejnullah Rrahmani, Letërsia e Lindjes, SHB”Faik Konica”, Prishtinë, 2005, f. 192-193.

Prandaj edhe “bejti” Naimian nuk mbetet prapa burimit, pra prapa “Masnavisë” së Rumi e që këtu jepet përmes një rrëfimi që bën fyelli:

“Që kur se më kanë ndarë
Nga shok’ e nga miqësia,
Gra e burra kanë qarë
Nga ngashërimet e mija!”

Ndërsa në “Masnavinë” e Rumi, Fyelli premt, te Naimi, ai e realizon premtimin, premtimi është i kryer dhe fjalët e fyellit i thotë subjekti lirik nga brendia e shpirtit me ç’rast arrihet një gradacion tejet i fuqishëm në klimaks, prandaj edhe invokacioni në gradacion demostenik:

“ O rrëmet i njerëzisë!
Zër’ i fyellit s’ është erë,
Ky është zjarr’ i dashurisë
Që i ra kallamit mjerë!

Prandaj edhe pasojat e “rënies”, këtu lojës në instrumentin e fyellit, do t’i shihni siç vijon, thotë Naimi.

“I ra qiellit e ndriti,
I ra zëmrës e nxehu,
I ra verës e buçiti,
I ra shpirtit, dhe e dehu.”

E jehonat e vajit të fyellit së pari bien mbi qiellin, pastaj nga qielli zbresin në zemër, nga zemra në verë, e nga vera në shpirtin e poetit, e ky shpirt nxehet sepse fyelli ka dhe mban efekt magjik i cili, sipas Naimit:

“I dha erë trëndafil, I dha dritë bukurisë,
I dha këngëtë bilbilit, I dha shije gjithësisë.”

e që këto dy tërësi të gradacionit sendërtohen me një varg anaforash që i japin ngjyrë të veçantë, ose edhe i mbajnë iso trandafilin, bukurisë, bilbilit dhe gjithësisë, e këtë iso, Naimi, njohës i polifonisë labe e çame, pra si frashëriot, e arrin me anë të anaforës: prej foljeve të parregullta: për të rënë dhe për të dhënë, përsëritur nga katër herë në klimaksin që shkon në qeill, në zemër, në verë e në shpirt, prandaj edhe klimaksi i dytë, për të dhënë, që shkon kah era, kah bukuria, kah kënga dhe në fund kah shija.

Pra, për t'i përmbyllur këto dy “bejte naimiane”, e “katrena të bukura” e që janë rubairat e krijimtarisë sonë romantike, na mjaftojnë pasojat e zërit të fyellit i cili i paska dhënë erë trandafilin, të njohur për kamjen e madhe të erës, i paska dhënë dritë bukurisë, pra të bukurës, ia paska dhënë këngën bilbilit i cili si shpend është i njohur për këngë, dhe fare në fund, korona poetike “fylli i dha shije gjithësisë”. Edhe këtu kemi një paralelizëm ndërmjet distikut:

“Me buzë të derdhur nga malli, plot zjarr do t'i bie gjithmonë
Që afshin pa fund dashuror në zemra të ndez me jehonë.”

Dhe, del se:

“Rënkimi i fyellit është flakë, nuk është er’ e lehtë pranverore,
Kush mbetet i ftohtë ndaj flakës, s’e ndjen këtë këngë madhështore.”

Edhe intonacioni eksklamativ me të cilin Naimi i drejtohet fyellit, i cili është një zjarr nga doli njeriu, është invokacion apostrofal tejet i butë, pra pasthirrmë që del nga një zemër altruiste, skofiare e melankolike të cilën e hetojmë porsa prekim e dëgjojmë “Fjalët e qiririt” apo “Fyellin”:

“O more zjar i bekuar,
Unë me ty jam përzjerë,
Po jam tretur e kulluar,
Po të kam shpirt, mos më lërë.”

Pra, “zjarri është i bekuar”, poeti është i shkrirë në këtë objekt që është zjarr i bekuar, prandaj edhe është tretur dhe kulluar.

Përfundimi

Në këtë punim trajtuam dy tekste, që të dyja këto tekste janë shumë të ngjajshme në përmbajtjen e tyre artistike, të shprehur figurativisht, në ndërtimin simbolik. Pra, e gjithë situata e dhënë te njëri apo tjetri autor të bën të kuptosh shumë lidhur me idetë e tyre krijuese, por edhe të lënë hapur idenë se mund të thuhet akoma më shumë. Po kështu, të befason fakti se problemi artistik shfaq dashuri e ideologji që të lënë hapur mendimin e idesë rrëfyese të tyre.

Bibliografia

Alijaj, Tasim, Rumi dhe thesaret e letërsisë, Vargje, studime e komente përpoetin e madh iranien, SHB “Albin”, Tiranë, 1997.

Gashi, Osman, Materiali i dhënë për krahasim.

Instituti Albanologjik i Prishtinës, Fjalori i gjuhës shqipe, Prishtinë.

Plasari, Aurel, Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve, SHB “Apollonia”, Tiranë, 1995.

Qosja, Rexhep, Prej tipologjisë deri te periodizimi, Prishtinë, 1979.

Rrahmani, Zejnullah, Letërsia e Lindjes, SHB “Faik Konica”, Prishtinë, 2005.

Tehmidari, Ahmed, Historia e letërsisë Perse, përkthim i Abdullah Rexhepit, Tiranë, 2008.

Velek, Rene & Voren, Ostin, Teoria e letërsisë, Prishtinë, 1982.